



**STATUTI I BORDIT EDITORIAL TË REVISTËS
SHKENCORE “*BULETINI I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*”**

Neni 1

Statusi, botuesi dhe bashkëautorët e revistës shkencore “Buletini i Shkencave Gjeologjike”

1. “Buletini i Shkencave Gjeologjike” është revistë shkencore e njohur nga institucioni përgjegjës për certifikimin e revistave shkencore të Republikës së Shqipërisë.
2. Ai botohet nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, të paktën një herë në vit, në mënyrë të pandërprerë.
3. “Buletini i Shkencave Gjeologjike” është vazhdim i revistës shkencore gjeologjike “Përmbledhje Studimesh”.
4. Si vit i fillimit të botimit të tij njihet viti 1964, kur është botuar për herë të parë “Përmbledhje Studimesh”.
5. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është botuesi i Buletinit të Shkencave Gjeologjike, në bashkëpunim me Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM) dhe Institutin e Gjeoshkencave (IGJEO).
6. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave dhe Instituti i Gjeoshkencave bashkëpunojnë nëpërmjet pjesëmarrjes në Bordin drejtues nëpërmjet “Buletinit të Shkencave Gjeologjike”, nxitjes për të botuar në këtë buletin të stafit të tij shkencor e mësimdhënës, studenteve dhe doktorantëve si dhe mbështetjes financiare nga burimet e tij apo nëpërmjet nxitjes së sponsorizimeve të ndryshme.

Neni 2

Bordi Editorial, krijimi, funksionimi dhe detyrat

1. Bordi Editorial është organi shkencor i cili drejton procesin e realizimit të “Buletinit të Shkencave Gjeologjike”.
2. Bordi Editorial përbëhet nga Kryetari i Bordit Editorial, Sekretari i Bordit Editorial dhe anëtarët e Bordit Editorial (gjithësej 7 anëtarë).
3. Të gjithë anëtarët e Bordit përfaqësojnë personalitete në fushën e gjeoshkencave, brenda dhe/ose jashtë vendit dhe duhet të kenë minimalisht titullin Doktor i Shkencave (Dr./PhD).
4. Përbërja e Bordit Editorial krijohet nga: tre anëtarë që përzgjidhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (Kryetari i Bordit, Sekretari i Bordit Editorial dhe një anëtar tjetër), dy anëtarë që përzgjidhen nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, ndërsa dy anëtarë përzgjidhen nga Instituti i Gjeoshkencave.
5. Kandidaturat brenda Shërbimit Gjeologjik Shqiptar përzgjidhen nga Drejtori i Përgjithshëm, ndërsa ato të përzgjedhura nga insitucionet e sipërpërmendura i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, dhe certifikohen prej tij nëpërmjet “Urdhërit për ngritjen e Bordit Editorial të Revistës Shkencore Buletini i Shkencave Gjeologjike”.
6. Shkarkimi i një anëtari dhe i gjithë Bordit Editorial bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar kur çënohet rëndë imazhi i Buletinit të Shkencave Gjeologjike nga veprimi ose mosveprimi i një anëtari të Bordit apo i gjithë Bordit.
7. Anëtarët e jashtëm të Bordit (FGJM dhe IGJEU) marrin pjesë me të drejtë votë, në takimet fizike dhe on-line, në shqyrtimin dhe miratimin e artikujve dhe ekspertizave, në

miratimin e dokumenteve të ndryshme të paraqitura nga Kryetari i Bordit dhe mbështesin procesin e promovimit të Buletinit në institucionet përkatëse ku ata janë pjesë.

Neni 3

Mandati i Bordit Editorial, zgjedhja dhe rizgjedhja e anëtarëve të Bordit Editorial

1. Mandati i Bordit Editorial është 3 (tre) vjeçar.
2. Mandati fillon prej mbledhjes së parë të tij. Bordi zhvillon mbledhjen e tij të fundit brenda muajit të fundit të mandatit dhe në këtë mbledhje paraqet vendimin për përfundimin e veprimtarisë dhe tërheqjes së tij dhe i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me kërkesën për të certifikuar Bordin Pasardhës.
3. Anëtarët e Bordit Editorial kanë mandat që zgjat aq sa mandati i Bordit Editorial, prej mbledhjes së parë e deri në mbledhjen e fundit. Ata mund të zgjidhen deri në dy mandate pa ndërprerje.

Neni 4

Kryetari i Bordit (Kryeredaktori): Zgjedhja, detyrat dhe mandati i Kryetarit të Bordit Editorial

1. Kryetar i Bordit Editorial emërohet një nga anëtarët e Bordit propozuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Ai mban njëkohësisht edhe pozicionin e Kryeredaktorit të revistës.
2. Emërimi i Kryetarit të Bordit bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar nëpërmjet *“Urdhërit për ngritjen e Bordit Editorial të Revistës Shkencore Buletini i Shkencave Gjeologjike”* dhe certifikohet në mbledhjen e parë të Bordit të ri.
3. Kryetari i Bordit Editorial udhëheq veprimtarinë e Bordit Editorial prej momentit të mbledhjes së parë, deri në mbledhjen e fundit të Bordit që ai drejton.
4. Ai harton dhe paraqet për diskutim politikën editoriale të revistës shkencore dhe është garant i etikës, barazisë në trajtim, lirisë së shprehjes dhe mendimit, i të drejtave të autorit që rrejdhin nga ligjet shqiptare dhe konventat ndërkombëtare, si dhe mbrojtjes nga diskriminimi i çdo lloji.
5. Së bashku me Sekretarin mban kontaktin me autorët për çështje të ndryshme lidhur me artikujt e tyre dhe mbulon procesin e redaktimit teknik dhe shkencor të artikujve.
6. Kryetari i Bordit Editorial mund të rizgjidhet në këtë detyrë, por jo më shumë se dy herë pa ndërprerje.
7. Së bashku me Sekretarin, mban të gjithë dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon atë çdo vit bashkë me Buletinin e botuar, pranë Drejtorisë së Programim – Zhvillimit, Sektori i Programimit dhe Publikimeve.
8. Raporton çdo 3 (tre) muaj pranë Sektorit të Programimit dhe Publikimeve (ShGjSh), mbi aktivitetin e Bordit Editorial.

Neni 5

Dorëheqja e Kryetarit të Bordit Editorial dhe mënyra e zëvendësimit të tij

1. Kryetari i Bordit Editorial mund të lerë detyren e tij edhe nëpërmjet dorëheqjes.
2. Dorëheqja nga posti i Kryetarit të Bordit Editorial, nuk nënkupton automatikisht dorëheqjen nga anëtarësia e tij në Bordin Editorial, prandaj në rast dorëheqjeje, ai qëndron përsëri si anëtar i Bordit Editorial.
3. Mbas dorëheqjes së Kryetarit të Bordit Editorial, një nga anëtarët e tjerë të Bordit emërohet “Kryetar i Bordit Editorial”.

4. Mandati i “Kryetarit të Bordit Editorial”, përfundon me mbarimin e mandatit të Bordit që ai kryeson.
5. Nëse Kryetari i Bordit bën dorëheqje të dyfishtë, pra edhe nga posti i anëtarit të Bordit Editorial, më parë bëhet zëvendësimi i tij nga një anëtar i ri i propozuar nga institucioni prej të cilit vjen Kryetari i Bordit dhe pastaj bëhet emërimi i Kryetarit të Bordit Editorial.
6. Kryetari që dorëhiqet, nëse kjo ndodh në kohën kur ai po ushtronte mandatin e tij të dytë, ai nuk gëzon të drejtën e emërimit në krye të Bordit pasardhës, sepse mandati i tij do të konsiderohet i konsumuar, pavarësisht dorëheqjes.
7. Kryetari i Bordit, i emëruar në mes të mandatit, ka të drejtën e rizgjedhjes si kryetar edhe njëherë.

Neni 6

Shkarkimi i Kryetarit të Bordit Editorial dhe mënyra e zëvendësimit të tij

1. Kryetari i Bordit Editorial mund të shkarkohet vetëm atëherë kur ai:
 - a. në mënyrë të vetëdijshme, me veprime apo mosveprime, ka favorizuar botimin në faqet e Buletinit të artikujve me karakter fyes e denigrues, apo me përmbajtje diskriminuese ndaj fesë, racës, etnisë apo prirjeve seksuale të një personi apo një grupi personash;
 - b. kur ai me deklaratimet e tij, shkel ligjin për mosdiskriminimin në Republikën e Shqipërisë;
 - c. kur nuk ka marrë parasysh ruajtjen e të drejtave të autorit të një dorëshkrimi të dorëzuar, apo të pjesëve të cituara nga vepra të tjera në një dorëshkrim të dorëzuar;
 - d. kur pengon botimin e një dorëshkrimi, i cili bie ndesh me pikëpamjet e tij personale.
2. Shkarkimi i Kryetarit të Bordit për shkeljet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni bëhet si më poshtë:
 - a. Kur ngrihet akuza se preket nga ndonjë prej veprave të pikës 1 të këtij neni.
 - b. Në këtë rast Bordi Editorial mbledhet të shqyrtojë çështjen në një mbledhje, që drejtohet prej Sekretarit të Bordit, në të cilën, Kryetari i Bordit merr pjesë vetëm për të paraqitur pretendimet e tij.
 - c. Në fund të mbledhjes bëhet votim i fshehtë mbi argumentin e diskutuar dhe në rast se akuza pranohet nga 4 prej 7 anëtarëve, i kalohet Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar propozimi për vendimarrjen përfundimtare.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, vendos për **“paralajmërim për shkarkim”** ose për **“shkarkim”** të Kryetarit dhe ja përcjell vendimin Bordit Editorial.
4. Vendimi **“paralajmërim për shkarkim”** mund të merret vetëm një herë dhe në një rast të përsëritur Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, është i detyruar ta shkarkojë përfundimisht Kryetarin e Bordit Editorial.
5. Mbas vendimit për shkarkim të Kryetarit të Bordit Editorial, fillon procedura për zgjedhjen e Kryetarit të Bordit Editorial, sipas neni 5 të këtij Statuti.

Neni 7

Anëtarët e Bordit Editorial, detyrat, dorëheqja dhe shkarkimi

1. Shqyrtojnë, vlerësojnë artikujt shkencorë të paraqitur.
2. Votojnë për caktimit e ekspertëve të artikujve shkencorë, që do të kryejnë vlerësimin shkencor të jashtëm të artikujve të paraqitur.

3. Miratojnë artikujt përfundimtarë, që do të botohen dhe rradhën e paraqitjes të artikujve në Buletin.
4. Për dorëheqjen ose shkarkimin e anëtarëve dhe sekretarit, ndiqen të njëjtat procedura të parashikuara për Kryetarin e Bordit Editorial në Nenet 5 dhe 6 të këtij statuti.

Neni 8

Sekretari i Bordit Editorial, detyrat dhe kohëzgjatja e mandatit

1. Së bashku me Kryetarin e Bordit Editorial zbaton politikat e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në fushën e Botimeve Shkencore. Emërohet dhe shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
2. Merr pjesë në mbledhjet e Bordit Editorial, me të drejtë votë.
3. Mbulon procesin e protokollimit të mbledhjes.
4. Merr në dorëzim dorëshkrimet nga autorët dhe i kontrollon për realizimin në to të "Kërkesave ndaj autorëve". Informon dhe paraqet artikullin e Bordit Editorial për njohje paraprake në rrugë elektronike.
5. Së bashku me Kryetarin, mban kontaktin me autorët për çështje të ndryshme lidhur me artikujt e tyre dhe mbulon procesin e redaktimit teknik dhe shkencor të artikujve.
6. Harton procesverbalet e mbledhjeve të Bordit Editorial.
7. Harton listat e pagesave për anëtarët e Bordit Editorial.
8. Harton listat e pagesave për ekspertët e artikujve.
9. Mbulon procesin e publikimit on-line të revistës.
10. Së bashku me Kryetarin, mban të gjithë dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon atë çdo vit bashkë me Buletinin e botuar, pranë Drejtorisë së Programim – Zhvillimit, Sektori i Programimit dhe Publikimeve.

Neni 9

Redaktori Teknik, detyrat dhe kohëzgjatja e mandatit

1. Redaktor teknik caktohet një nga specialistët e Sektorit të Programimit dhe Publikimeve. Përzgjedhja bëhet nga Përgjegjësi i Sektorit të Programimit dhe Publikimeve (Drejtoria e Programim – Zhvillimit).
2. Mbulon procesin përfundimtar të redaktimit teknik (çdo gjë që lidhet me pjesën grafike të Buletinit, faqosja përfundimtare e Buletinit në programet përkatëse si: InDesign, Vellum etj.)
3. Ndjek procesin e botimit dhe kontrollon zbatimin e shpërndarjes së revistës.
4. Merr në dorëzim nga Sekretari/Kryetari arkivën e dorëshkrimeve të dorëzuar dhe dokumentacionin lidhur me to, si dhe dorëzon një kopje origjinale të Buletinit çdo vit në Arkivin Qendror Teknik të SHGJSH-së, si pjesë e materialit shkencor me afat ruajtje deri në 5 vjet.

Neni 10

Mbledhjet e Bordit Editorial, mënyra e thirrjes dhe diskutimet në to

1. Mbledhjet e Bordit thirren nga Kryetari i Bordit Editorial. Ai njofton anëtarët për mbledhjen e rradhës të paktën një javë më parë. Njëkohësisht njofton Sekretarin që të dërgojë nëpërmjet e-mail-it të gjithë dokumentacionin (artikuj për tu diskutuar, përgjigje ekspertizash apo projekt-vendime), që do të diskutohen në mbledhje.

2. Bordi diskuton dhe voton politikat editoriale të paraqitura nga Kryetari i Bordit, përcaktimin e ekspertit të artikujve, vendimin për të pranuar apo për ta refuzuar për botim një artikull, bazuar në kriteret e vlerësimit, apo vendimet e ekspertizës, çështje të së drejtës së autorit, përzgjedhjen e rradhitjes së artikujve në revistë në çastin kur ai çohet për shtyp dhe korrektesën e eksperteve në përputhjen e vlerësimit me kërkesat e formularit të ekspertizës. Mund të propozojë ndryshime në statut.
3. Proçesverbali i mbledhjes (i zbardhur) firmoset nga Kryetari dhe Sekretari i Bordit Editorial.
4. Në mbledhjet fizike, anëtarët e Bordit Editorial firmosin për çdo pjesëmarrje.

Neni 11

Rregullat e vendimarrjes në Mbledhjet e Bordit Editorial

1. Vendimarrja në Bordin Editorial merret me shumicë votash.
2. Minimumi i votës për vendimarrje është 50% e votave plus 1.
3. Anëtarët e bordit kanë të drejtën e njëres nga tre mënyrat e votimit: “Pro”, “Kundër” apo “Abstenim”, ku dy të parat llogariten si një votë e plotë, ndërsa e treta me zero.
4. Në rastin kur votat “Pro” dhe “Kundër” janë të barabarta, vendos vota e Kryetarit.
5. Kryetari i Bordit Editorial mund të votojë vetëm “Pro” dhe “Kundër”.
6. Mbledhja e Bordit mbahet kur janë të pranishëm bashkë të paktën 5 vetë nga Bordi Editorial.

Neni 12

Mbledhjet dhe diskutimet On-line, mënyra e votimit, vlefshmëria, dokumentimi dhe afatet

1. Mbledhjet On-line:
 - a. Përveç mbledhjeve fizike, për çështje të caktuara, Kryetari i Bordit drejtues ka të drejtë të organizojë mbledhje on-line (në platforma si Google Meet, Zoom, Teams etj.). Ai njofton anëtarët për mbledhjen e rradhës të paktën një javë më parë dhe dërgon linkun me ftesën në takim një/dita ditë para mbledhjes on-line, duke ndjekur të njëjtat procedura si në takimet fizike.
 - b. Mbledhja on-line mbahet kur janë të pranishëm bashkë të paktën 5 anëtarë nga Bordi Editorial.
 - c. Votimi bëhet gjatë mbledhjes dhe vendimi quhet i marrë nëse deklarojnë mendimin e tyre të paktën katër nga anëtarët e Bordit dhe vota përcakton shumicën, 50% plus 1 të pjesëmarrësve në votim.
 - d. Rezultati i këtij votimi shkruhet në proçesverbalin e mbledhjes on-line.
2. Diskutimet nëpërmjet e-mail-it:
 - a. Kryetari i Bordit drejtues mund të hapë diskutime edhe nëpërmjet e-mail-eve, në të cilat përfshin të gjithë anëtarësinë e Bordit Editorial. Anëtarët kthejnë përgjigje brenda një javë dhe përgjigjet e anëtarëve protokollohen nga Sekretari.
 - b. Në fund të diskutimit nëpërmjet e-mail-eve, Kryetari i Bordit mund të kërkojë marrjen e një votimi nëpërmjet e-mail-it. Votimi zgjat tre dite dhe vendimi quhet i marrë nëse deklarojnë mendimin e tyre të paktën katër nga anëtarët e Bordit dhe vota përcakton

shumicën 50% plus 1 të pjesmarrësve në votim. Rezultati i këtij votimi shkruhet në procesverbalin e mbledhjes së rradhës.

- c. Propozimi për një votim të tillë mund të anulohet nëse tre prej anëtareve e refuzojnë këtë. Në këtë rast vendimmarrja mbi çështjen e diskutuar merret në mbledhjen e ardhshme të Bordit Editorial.

Neni 13

Caktimi i ekspertëve të jashtëm për artikujt

1. Vlerësimi shkencor i artikujve bëhet nga ekspertët e jashtëm.
2. Për të vlerësuar artikujt e paraqitur nga pikëpamja e vlerave shkencore, Bordi Editorial cakton nëpërmjet diskutimit dhe votimit ekspertin përkatës. Për çdo artikull propozohen minimalisht dy ekspertë dhe zgjidhet një.
3. Eksperti duhet të jetë profesionist i fushës dhe njohës i mirë i metodikës që trajton artikulli. Ai nuk mund të jetë pjestar i Bordit Editorial ose bashkëautor i artikullit të paraqitur.
4. Eksperti kontraktohet nëpërmjet një kontrate tip, të hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar të nënshkruar nga eksperti i kontraktuar, Kryetari i Bordit dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
5. Kur Bordi e shikon të arsyeshme për shkak të vështirësisë së artikullit apo kompleksitetit të temave që trajtohen në të, mund të caktohen dhe kontraktohen dy ekspertë.
6. Një ekspertizë e dytë mund ti bëhet një artikulli, kur Bordi e gjykon se eksperti i parë nuk ka arritur ti trajtojë të plota të gjitha kërkesat.
7. Eksperti e trajton artikullin brenda kohës së përcaktuar në kontrate dhe në bazë të pyetësorit të miratuar, i emërtuar “Formular i ekspertizës”, i cili është dokument standart i dorëzohet ekspertit sëbashku me artikullin, nëpërmjet njërit prej e-mail-eve zyrtare.
8. Emri i ekspertit mbahet i fshehtë për autorin e artikullit dhe emri i autorit të artikullit mbahet i fshehtë për ekspertin, për të eliminuar mundësinë e ndikimit negativ në vlerësim.
9. Eksperti duhet të ketë minimalisht titullin shkencor Doktor (Dr./PhD).

Neni 14

Marrëdhëniet me autorët e artikullit, mënyra e dorëzimit dhe pranimi i artikujve, kthimi i përgjigjeve

1. Çdo autor që kërkon të botojë në “Buletinin e Shkencave Gjeologjike”, duhet të respektojë disa kërkesa standarte, të cilat janë të nevojshme për të siguruar cilësinë shkencore dhe vizive të botimit, barazinë, të drejtën e shprehjes, etikën e shprehjes dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.
2. Autorësia duhet të jetë e limituar vetëm për ata që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm teknik në punën e paraqitur në dorëshkrim.
3. Renditja e autorëve duhet të dakortësohet nga të gjithë autorët dhe nuk mund të ndryshohet ndërkohë që dorëshkrimi është dorëzuar.
4. Asnjë individ që ka dhënë një kontribut të rëndësishëm teknik në punën e paraqitur në dorëshkrim, nuk duhet të përjashtohet nga autorësia.

5. Autorët dorëzojnë një *Deklaratë bashkëautorësie*, ku dëshmojnë se e dinë që janë bashkëautorë në këtë punim dhe se pranojnë si autor të parë, autorin të cilit i shkruhet emri i pari dhe që caktohet përgjegjës për korrespondencën me Bordin Editorial.
6. Ata duhet të deklarojnë se kanë parë versionin përfundimtar të materialit dhe kanë rënë dakort për paraqitjen e tij për botim. Asnjë emër fiktiv nuk duhet të jepet si autor ose bashkëautor.
7. Autorët e dërgojnë artikullin e tyre në mënyrë elektronike nëpërmjet e-mail-it zyrtar, ose në një prej e-mail-eve të paraqitura në sitin e Buletinit (Sekretari/Kryetari). Kopja elektronike do të jetë e ndarë në materialin e parë në format *.pdf* (ku përfshihen të gjitha materialet grafike dhe tabelat të vendosura brenda në tekst në pozicionet përkatëse) dhe në materialin i dytë në format *.doc* ose *.docx* vetëm teksti pa figura. Të gjitha materialet grafike (figurat, tabelat, skicat, grafikët, foto etj.) do të dorëzohen në një folder në momentin e dorëzimit të variantit përfundimtar të artikullit (pas ekspertizës së jashtme dhe ndryshimeve të kërkuara prej saj).
8. Autorët plotësojnë një *Deklaratë antiplagjiaturë*, në të cilin pranojnë se mbajnë përgjegjësi përpara ligjit për të drejtat e autorit, për ato që kanë paraqitur në këtë artikull.
9. Pas marrjes së artikullit me e-mail, Sekretari bën kontrollin e përputhshmërisë së formatimit me standardet e Buletinit (Kërkesat ndaj autorëve) dhe kryen verifikimin on-line, nëqoftëse artikulli është plagjiaturë apo jo, nëpërmjet motorëve kërkimorë.
10. Çdo shkelje e këtyre parametrave i raportohet Kryetarit, i cili propozon në mbledhjen e parë fizike/on-line, që artikulli ti kthehet autorit për ripunim për ta përputhur atë me kërkesat e formatimit.
11. Nëse artikulli i respekton kërkesat, ai kalon në Bordin Editorial për diskutim dhe për përcaktimin e ekspertit të jashtëm.
12. *Deklarata e bashkëautorësisë* (Shtojca 1) dhe *Deklarata antiplagjiaturë* (Shtojca 2), u dërgohen autorëve pas shqyrtimit fillestar të artikullit nga Bordi Editorial dhe marrjes së vendimit për procedura të mëtejshme.
13. Nëse eksperti e vlerëson artikullin të përshtatshëm për botim sipas kriterëve të përcaktuara të ekspertizës, ai diskutohet në Bordin Editorial. Në bazë të ekspertizës së jashtme të artikullit Bordi Editorial vendos botimin ose jo të tij.
14. Nëse Bordi vendos për botimin e artikullit, Redaksia i dërgon autorit me e-mail, një informacion përmbledhës me vërejtjet e anëtarëve të bordit dhe të ekspertizës së jashtme.
15. Autorët duhet të kthejnë artikullin përfundimtar të korigjuar, në gjuhën shqipe dhe në format *.doc/.docx* me e-mail, brenda 14 ditësh nga marrja e njoftimit të pranimit për botim.

Neni 15

Kërkesat ndaj autorëve

1. Ky nen ka për qëllim njohjen e autorëve që paraqesin artikuj për botim në “Buletini i Shkencave Gjeologjike”, me kërkesat teknike që duhen zbatuar për paraqitjen e këtyre artikujve.
2. Dorëshkrimi i dorëzuar duhet të jetë origjinal dhe i pa publikuar më parë dhe i padorëzuar për publikim në një vend tjetër. Dorëshkrimi dorëzohet në gjuhë korrekte shqipe dhe pas

vendimit të Bordit Editorial për botim autori e përkthen atë në gjuhën anglisht korrektësisht shkencore.

3. Në formën elektronike, në dorëzimin fillëstar, përfshihen dy forma. Forma e parë përfshin një material në **format PDF**, ku të përmbledhë artikullin e plotë me tekst, material grafik dhe tabelat me diçitura sipas renditjes që autori/autorët mendojnë ta botojnë. Në formën e dytë në **MS Word**, do të paraqitet pjesa tekst në format (.doc apo .docx), e cila përfshin tekstin dhe diçiturat e materialit grafik dhe tabelave, të cilat do të vihen në fund të materialit. Në dorëzimin përfundimtar, i gjithë materiali grafik (foto, figura, grafike, skica, diagrama) në format **JPEG, JPG, TIFF** dhe tabelat në formatin e MS Word, duhet të jenë vendosur në një folder. Këto materiale grafike dhe tabelat, duhet të llogariten që të jenë shprehëse brenda formatit të një kolone (përmasat 80x150 mm), ose dy kolonave (një faqeje të plotë me permasa 124x150mm).
4. Artikulli i plotë, duhet të përfshijë një total prej **12 faqesh** tekstin, materialin grafik dhe tabelat së bashku me diçiturat përkatëse, si dhe listën e referencave. Nëqoftëse artikulli ka materiale shtesë të cilët nuk mund të përfshihen brenda artikullit fizik (tabelat të gjata, figura, tekst, për të mbështetur studimin në fjalë), të gjitha këto mund të publikohen në suplementin elektronik, i cili do jetë vetëm në variatin on-line.
5. Në faqet e Buletinit, ka vend për një rubrikë diskutimesh, apo artikujsh **“Case Study”** të cilat trajtojnë në formë të hollësishme një problem gjeologjik me rëndësi kombëtare në konceptin shkencor. Në këtë rast artikulli pranohet në gjuhën shqip, deri në maksimumi 15-16 faqe me një përmbledhje në gjuhën angleze jo më pak se 2 faqe dhe jo më shumë se 3 faqe.
6. Përmbledhja që e shoqëron, duhet patjetër të citojë të gjithë kapitujt e artikullit, duke cituar figurat dhe çdo koncept. Për shqyrtimin e tij redaksia cakton një grup anëtarësh i cili i vjen në ndihmë autorëve, në mënyrë që ata të theksojnë sa më mirë konceptet e tyre në artikull dhe në përmbledhje.

Neni 16

Standartet e dorëshkrimit

1. Teksti i dorëshkrimit paraqitet në madhësinë e faqes A4 (përmasa 21x29.7cm), hapësira mes rrjeshtave **“Line spacing” = 1.15 pt**, ç’ka nënkupton një sasi të përafërt prej 500 fjalësh për faqe. Rrjeshtat e tekstit duhet të jenë të numëruar (nga rrjeshti i titullit deri në fund të referencave) duke nisur nga njëshi (**Layout – Line numbers**) pa ndërprerje.
2. Përmasat e shkrimit **“font size”** duhet të jenë 12pt (Times New Roman) dhe hapësirat në anët e fletës **“margins” do të jetë 3 cm** në anën e majtë (Left margin) dhe **2,5 cm** në anët e tjera (lart – top; djathtas – right; poshtë – bottom). Faqet duhet të jenë renditur sipas numrit të tyre (**Page number**) duke nisur nga njëshi.

Neni 17

Skema e ndërtimit të artikullit

A. Artikulli do të ndërtohet duke respektuar skemën e mëposhtme:

1. **Titulli** (**BOLD, TIMES NEW ROMAN 14 pt, SHKRONJA KAPITALE**). Sa më i shkurtër dhe përmbledhës të jetë e mundur.

2. **Autorësia** (BOLD, TIMES NEW ROMAN, SHKRONJA KAPITALE 12 pt; *Institucionet: Times New Roman, pt 10, Italic*). Emër Mbiemër shoqëruar me *indekse sipër mbiemrit* ⁽¹⁾, ⁽²⁾ etj., të cilët shoqërohen me *referimin e plotë* të emërimit dhe adresën e institucionit nga vjen autori, që i përkon indeksi. Indekset me adresat renditen menjëherë poshtë autorëve, secila në një rresht duke nisur nga adresa e autorit të parë (Institucioni, Departamenti, Qyteti, Shteti), e cila shoqërohet dhe me një kontakt e-maili, nëpërmjet të cilit Bordi Editorial mban lidhjet me të.

Psh.: PANDELI PASHKO¹* & KUJTIM ONUZI²

¹Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjelogjisë dhe Minierave, Rr....., Tiranë, Albania.

²Instituti i Gjeoshkencave, Mjedisit dhe Ujit, Rr. Don Bosko, Tiranë, Albania.

*autori korrespondent/corresponding author: pandi.pashko@yahoo.com

3. **Abstrakti** (*Times New Roman, Italic 10 pt*). Duhet të jetë maksimumi 250 fjalë dhe të përmbledhë shkurtimisht qëllimin e punimit, përfundimet dhe rezultatet kryesore. Abstrakti nuk duhet të përmbajë referenca dhe shkurtime apo të tejkalojë gjatësinë e pranuar.
4. **Fjalët Kyçe** (*Times New Roman, Italic 10 pt*) – një minimum prej 4 fjalë dhe një maksimum prej 7 fjalësh kyç, të renditura nga fjalët më të përgjithshme tek ato më specifike, si psh.: *Jurasik, Albanidet e Brendshme, Zona Mirëdita, ofiolite, ultrabazikë* etj.
5. **Teksti kryesor** (Normal, Times New Roman 12 pt) me vendosje në anën e majtë (Paragraph – Align Left). Ndërtohet i ndarë në seksione deri në maksimumi katër nivele sipas rradhës:
- Seksioni niveli i parë (BOLD, UPPERCASE). Titulli i seksionit: **HYRJA (INTRODUCTION) – NDËRTIMI GJEOLGJIK (GEOLOGICAL SETTING) – METODOLOGJIA (METHODOLOGY) – REZULTATET DHE DISKUTIMI (RESULTS AND DISCUSSIONS) – PËRFUNDIME (CONCLUSIONS) – Falëndërimet (Acknowledgements) – Referenca (References).**
 - Seksioni i nivelit të dytë – Titulli (Bold, gërma e parë e fjalës së parë dhe emrat e përveçëm fillojnë me shkronjë kapitale, të tjerat me të vogla).
 - Seksioni i nivelit të tretë: *Titulli (Italics, Bold, gërma e parë e fjalës së parë dhe emrat e përveçëm fillojnë me shkronjë kapitale, të tjerat me të vogla).*
 - Seksioni i nivelit të katërt (të përdoret sa më pak): *Titulli (Italics, gërma e parë e fjalës së parë të jetë kapitale).* Pas titullit vendoset **pikë**, dhe teksti (Normal) shkruhet në vazhdim të tij, jo në rresht tjetër.

B. Ndarrjet e dorëshkrimit:

- HYRJA (INTRODUCTION)** – duhet të jetë e shkurtër, të japë informacion mbi problematikën e trajtuar dhe të përcaktojë **qëllimi/qëllimet e studimit**.
- NDËRTIMI GJEOLGJIK (GEOLOGICAL SETTING)** – përmban përshkrimin gjeologjik të zonës së studiuar të bazuar mbi literaturën e njohur.
- METODOLOGJIA (METHODOLOGY)** – duhet të përmbajë informacion mbi: *vendodhjen e profileve, litologjia dhe materialin e mbledhur* (kampionët e marra dhe

vendodhja e tyre brenda një profili), metodologjia e përdorur për *mënyrën e përpunimit të kampioneve të cilat ndryshojnë sipas qëllimit* (shlife mineralogjike, përgatitje për analizë granulometrike ose gjeokimike, për difraktometri XDR, shlife mikropaleontologjike, larje foraminiferash etj.), mënyra e *analizimit të kampioneve të përgatitura* (psh.: Mikroskop për mineralogji, mikropaleontologji, sedimentologji; XDR dhe analiza gjeokimike për sedimente dhe shkëmbinj etj.). Tek metodologjia hyn edhe *analizat e cilësisë së materialit nga ana vizuale* (kampionatura e marrë në terrën, fenomene alterimi të mineraleve në mikroskop dhe cilësia e mikrofosileve në mikroskop), *analizat sasiore* (psh.: numërimi që bëhet për mineralogji, sedimentologji, mikropaleontologji etj.), si dhe *analizat statistikore* për përpunimin dhe interpretimin e tyre me programe të ndryshme kompjuterike.

4. REZULTATET DHE DISKUTIMI (RESULTS AND DISCUSSIONS) – duhet të përmbajë vetëm rezultatet e studimit në fjalë dhe interpretimin e tyre, krahasimin e rezultateve të studimit me literatura të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, ngjashmëritë, ndryshimet dhe të rejat që dalin nga ky studim.

5. PËRFUNDIME (CONCLUSIONS) – të jenë të shkurtra dhe të lidhen direkt me studimin e paraqitur, pa përmendur përfundimet e artikujve të tjerë nga literatura. **Psh.:** Për herë të parë është studiuar zona..., përmendur minerali..., gjetur një fosil të ri; ose është përdorur një metodë ndryshe etj.

6. Falendërime (Acknowledgments) – të jenë të shkurtra. Mund të përmbajnë emra të specialistëve (jo autorë) të ndryshëm, që mund të kenë ndihmuar në faza të ndryshme të studimit dhe informacion mbi financimin e studimit (grante nga agjensi të ndryshme, bursa për studentë të fituara nga specialistët, gjithmonë në kuadër të studimit).

7. Referencat/References

a. Në tekst referencat citohen sipas *kronologjisë* nga më e vjetra tek më e reja (viti i publikimit), vetëm me mbiemrin e autorit të parë dhe vitin si psh.: në kllapa (*Pashko 1965; Pashko et al. 1973; Grabowski 2011, 2018*), ose *Pashko (1965), Pashko et al. (1973), Grabowski (2011, 2018), Onuzi (2021), Marku & Onuzi (2022)*.

- Nëqoftëse kemi referenca të të njëjtit autor të publikuar në të njëjtin vit, brenda tekstit dhe në listën e referencave, duhet të ndahen duke përdorur indekse (a, b, c sipas alfabetit latin) sipas modelit: *Pashko (1965 a, b) ose (Pashko 1965 a, b)*.
- Për referenca në tekst me më shumë se dy autorë, do të citohet vetëm autori i parë, sipas modelit: *Pashko et al. 1973*.

b. Lista e referencave duhet të përmbajë vetëm studime të cituara në tekst dhe të cilat janë publikuar (në print ose on-line, ose janë pranuar për publikim).

- Në listë, referencat duhet të renditen **alfabetikisht** dhe pastaj sipas **kronologjisë**. Për referenca me dy autorë, vihet alfabetikisht sipas autorit të parë dhe pastaj sipas autorit të dytë dhe pastaj sipas kronologjisë.
 - Titujt e artikujve në gjuhë të tjera (përfshihen këto në anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), duhet të përkthehen në gjuhën angleze në kllapa.
 - Autorët duhet të shtojnë edhe identifikuesin digjital të çdo artikulli (DOI), ose ISSN, nëqoftëse ka.
 - Emrat e revistave/buletineve duhet të jenë të plota.
- c. Referenca të raporteve, tezave** duhet të përfshihen në rastin kur informacioni është

publikuar në artikuj të ndryshme. Në këtë rast do të citohen artikujt.

- d. Autorët/referencat e specieve, gjinive, familjeve, klasave nuk do citohen në tekst as në diçiturat e figurave (psh.: Linnaeus 1758 nuk do të citohet në tekst kur autorët do përmendin klasën e Bivalvorëve). Këto mund të përfshihen në një *listë të veçantë (Shtojca/Appendix)* në fund të artikullit, gjithmonë sipas species përkatëse, të renditura alfabetikisht.

- e. Shëmbuj forma standarte:

Artikull/Article:

Adrianova K.I., Myatlyuk E.V., Pashko P., Safonovo V.S. & Papa A. (1961). Stratigrafia srednevo miocena NR Allbanii [Stratigraphy of the Miocene sediments from Albania]. Tom. I, Vlorë (In Serbian).

Agnini C., Fornaciari E., Raffi I., Catanzariti R., Pälike H., Backman J. & Rio D. (2014). Biozonation and biochronology of Paleogene calcareous nannofossils from low and middle latitudes. *Newsletters on Stratigraphy*, 47(2), 131-181. <http://dx.doi.org/10.1127/0078-0421/2014/0042>

Chiari M., Marcucci M., Cortese G., Ondrejčková A. & Kodra A. (1996). Triassic radiolarian assemblages in the Rubik area, and Cukali zone, Albania. *Ofioliti, Special Issue*, 21(1), 77-84.

Kodra A. & Gjata K. (1982). Ofiolitet në kuadrin e evolucionit gjeotektonik të Albanideve. *Buletini i Shkencave Gjeologjike*, 2, 5-31.

Pashko P. (1965a). Pectinidet miocenike të Shqipërisë, gjinitë *Amussium* dhe *Variamussium* *Përmbledhje Studimesh*, 1, 113-124.

Pashko P. (1965b). Pectinidet miocenike të Shqipërisë, gjinitë *Amussium* dhe *Variamussium* [Miocene Pectinids in Albania Genera *Amussium* and *Variamussium*]. *Përmbledhje Studimesh*, 1, 113-124 (In Albanian).

Pashko P. (2018). Moravë Mt. Oligocene-Middle Miocene succession of Albanian-Thessalian Basin. *Bulletin of the Geological Society of Greece*, 52(1), 1-44.

Vathi K. (1989). Zonimi i nanofosileve gëlqerore në depozitat flishore të Zonës Jonike [Calcareous nannofossil zonation of the flysch deposits of the Ionian Zone]. *Buletini Nafta dhe Gazi, Instituti Gjeologjik i Naftës*, Fier, 1, 57-70 (In Albanian).

Vathi K. (1993). Biostratigrafia e nanofosileve gëlqerore të depozitave të moshës Oligocen i vonshëm – Miocen i hershëm të Zonës Jonike, Subzona Kurveleshi [Calcareous nannofossil biostratigraphy of Late Oligocene-Early Miocene deposits in the Ionian Zone, Kurveleshi Subzone]. *Buletini Nafta dhe Gazi, Instituti Gjeologjik i Naftës*, 4, 51–71 (In Albanian).

Vathi K. & Budri E. (1986). Interpretimi biostratigrafik të depozitave të moshës Oligocen i vonshëm – Miocen i hershëm të Zonës Jonike (Zona Kurveleshi) [Biostratigraphical interpretation of the Late Oligocene-Early Miocene deposits from Ionian Zone, Kurveleshi Area] based on calcareous nannofossils. *Fondi i Institutit Gjeologjik të Naftës*, Fier (In Albanian).

Libër/Book:

Pashko P., Papa A., Huta B. & Myftari A. (1973). Stratigrafia e depozitave Paleogjene dhe Neogjene të zonës tektonike të Mirditës. *Archives of Albanian Geological Survey*, p. 564.

Pashko P., Papa A., Huta B. & Myftari A. (1973). Stratigraphy of Paleogene and Neogene deposits from tectonic zone of Mirdita. *Archives of Albanian Geological Survey*, p. 564 (In Albanian).

Aliaj. Sh. (2012). Neotektonika e Shqipërisë. *Shtëpia botuese Klea, Tiranë*, p. 292.

Kapitull libri/Book chapter:

Perch-Nielsen K. (1985). Cenozoic calcareous nannofossils. In: Plankton stratigraphy (Bolli H.M., Saunders J.B. & Perch-Nielsen K. Eds.). *Cambridge University Press*, 427-554.

Vamvaka A., Kiliass A., Mountrakis D. & Papaoikonomou J. (2006). Geometry and structural evolution of the Mesohellenic Trough (Greece). A new approach. In: Tectonic Development of the Eastern Mediterranean Region (Robertson A.H.F. & Mountrakis D. Eds.). *Geological Society, London, Special Publications*, 260, 521-538.

Diploma doktoraturë/Phd Thesis:

Pana D.I. (1998). Petrogenesis and tectonics of the basement rocks of the Apuseni mountains: significance for the alpine tectonics of the Carpathian-Pannonian region. *PhD Thesis (Unpubl.)*, University of Alberta, Canada, p. 356.

Harta/Maps:

Biçoku T., Pumo E., Xhomo A., Papa A., Spiro A., Çili P. & Dede S. (1967). Harta Gjeologjike e Shqipërisë në shkallë 1: 200 000 (Plansheti xxxx). F.Q.GJ. Tiranë.

8. **Diçiturat/Captions** – duhen paraqitur nën çdo figurë, në shqip dhe anglisht, bashkë me referimet përkatëse në tekst.

9. Tabelat

a) Duhet të përgatiten në një madhësi prej një kolonë (përmasat 80x150 mm), ose dy kolona (një faqe të plotë me përmasa 124x150 mm). Të gjitha duhet të citohen në tekst sipas renditjes së shfaqjes së tyre.

b) Tabelat vendosen në fund të tekstit në faqe të ndara, vetëm me emërtimin si Tabela 1, Tabela 2 etj.

- Përgatiten me një font prej 7 pt (Times New Roman) në një lartësi të rreshtit (row) prej 8 pt.

- Referencat në tekst mund të jenë si: tabela 1 ose (Tab. 1 kur janë në kllapa).

- Tabelat shumë të gjata mund të publikohen në “**Suplementi On-line**” (Electronic supplement).

10. Figurat

a. Duhet të jenë të qarta, të cilësisë së lartë prej të paktën 300 dpi (jpeg, jpg, tiff). Për figurat bardhë-zi sugjerohet përdorimi i nuancave të grisë (299 shades of grayscale).

b. Në variatën përfundimtar, formati i tyre preferohet të dërgohen në Corel Draw, AutoCad etj. Të gjitha figurat mund të vendosen në një document CDR (CorelDraw) të renditura sipas shfaqjes në tekst (Figura 1, Figura 2....etj).

c. Trashësia minimale e linjave në vizatime duhet të jetë 0.25pt.

- d. Të gjitha hartat duhet të kenë: *shenjën e veriut, shkallë metrike dhe koordinatat përkatëse.*
 - e. Shkrimi mbi figurat duhet të jetë i kuptueshëm dhe në gjuhën përkatëse. Në variatin në shqip duhet të jenë në gjuhën shqipe, ndërsa në variatin në anglisht, duhen përkthyer në anglisht.
 - f. Nuk pranohen figura të skanuara nga burime të ndryshme.
 - g. Nëqoftëse figurat janë botuar më parë, autori merr përsipër të marrë lejen për ribotim nga revista ku janë botuar fillimisht. Nëqoftëse figurat janë ripunuar/rvizatuar nga autorët sipas një botimi tjetër, atëhere duhet referuar poshtë figurës, autori pas të cilit është bërë vizatimi (psh.: e ri-vizatuar sipas Xhomo et al. 2002, e modifikuar sipas Xhomo et al. 2002).
 - h. Legjendat e figurave të hartave duhen përfshirë brenda figurës, jo si diçiturë në përshkrimin e figurës (jo në Caption).
 - i. Planshetat (Plates) me fosile do të emërtohen si figurë. Çdo pamje fosili brenda figurës duhet të ketë një emër, një shkallë dhe të përcaktohet numrin i provës nëqoftëse është e mundur (psh.: *Praeorbulina glomerosa curva*, Mi-53/2017). Emrat e fosileve do të shkruhen poshtë çdo pamje fosili.
 - j. Referencat e figurave në tekst duhen si figura 1 ose (Fig. 1 në kllapa), ndërsa në listën e diçiturave duhen si Figura 1, Figura 2 etj.
11. Njësitë e përdorura në Buletin do ti përputhen Sistemit Ndërkombëtar të Njësive.
 12. Përdorimi i shkurtimeve është i lejuar vetëm pasi kuptimi i tyre është sqaruar në përdorimin e parë (psh. Nënzona Berat – NzB, Mt. – Mountain, *Praeorbulina glomerosa* – *P. glomerosa*, ATHB – Albanian-Thessalian Basin etj.).
 13. Emërtimet fosile shkruhen në tekst me *Italic*. Hera e parë që përmenden shkruhen të plotë (psh.: *Trisidos albanica*), pastaj mund të përdoren shkurtimet përkatëse (*T. albanica*). Lista të gjata me fosile mund të vendosen në suplementin on-line.
- C. Suplementi On-line (Electronic supplement)**
1. Përfaqëson një dokument të veçantë, i cili do të vendoset vetëm në buletin on-line dhe do të referohet në tekst si *Shtojca 1 (Suplement on-line)/Appendix 1 (Electronic Suppl.)*, *Shtojca 2 (Suplement on-line)/Appendix 2 (Electronic Suppl.)* dhe do të vendoset vetëm në buletin on-line.
 2. Mund të përmbajë tekst, tabela të gjata, figura të cilët nuk mund të publikohen në artikullin e printuar, për shkak se, tejkalohet sasia e faqeve të lejuar të revistës ose të madhësisë së tyre.
 3. Suplementi On-line do të dorëzohet në format Word (.doc/docx.) dhe do të ketë faqe të numëruara me vete nga 1, 2, 3 deri në fund të saj.
 4. Rradha e shtojcave duhet t'i përmbahet rradhës së citimit në tekstin e artikullit.
 5. Gjuha e përdorur në suplementin on-line do jetë shqip dhe/ose anglisht sipas rastit.

Neni 18

Formulari i ekspertizës së jashtme të artikullit të paraqitur në “Buletini i Shkencave Gjeologjike”

Formulari i ekspertizës (Shtojca 3) i dorëzohet ekspertit të caktuar nga Bordi Editorial bashkë me kriteret e vlerësimit, me anë të e-mailit (në format .doc), mbasi ai ka nëshkruar kontratën me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, çka tregon se ai e ka pranuar detyrën për ekspertizën e artikullit. Nëpërmjet këtij formulari kërkohet prej ekspertit të vlerësojë artikullin sipas kriterëve të vlerësimit të dorëshkrimit.

Neni 19

Kriteret e vlerësimit të dorëshkrimit

Nr.	Kategoritë e vlerësimit	Kriteret
a.	Botim i pranuar me pak korrigjime (Minor Revision)	• <i>Artikulli plotëson</i> kërkesat organizative të Buletinit dhe nuk paraqet probleme strukturore madhore; • <i>Qëllimet</i> e studimit janë të shprehur në mënyrë të qartë brenda Hyrjes; • <i>Paraqitja dhe bashkimi</i> i ideve dhe koncepteve janë të qartë dhe të kuptueshme; • <i>Metodologjia</i> e përdorur është e detajuar dhe e mbështetur plotësisht në rezultatet e nxjerra; • <i>Rezultatet</i> janë të shpjeguara shume mirë dhe <i>interpretimi</i> i tyre ka bazë shkencore të dokumentuar nëpërmjet referencave; mund të kërkohet shtim informacioni; • <i>Përfundimet</i> e paraqitura mbështesin plotësisht rezultatet e artikullit; • <i>Figurat</i> nuk kanë probleme madhore të konceptimit ose vizatimit në përgjithësi, por mund të duan njëfarë ripunimi minimal, shtimi, zëvendësimi i pamjeve të ndryshme, të cilat mund të jenë të paqarta, ose bashkimi i dy figurave etj.; • <i>Tabelat</i> janë të qarta dhe me informacion të mjaftueshëm; • Mund të duhet korrigjim të gjuhës dhe redaktim.
b.	Botim i pranuar me korrigjime mesatare (Intermediate Revision)	• <i>Artikulli plotëson shumicën</i> e kërkesave organizative të Buletinit, është relativisht i mirëorganizuar, por mund të duhen ndryshime në lëvizjen e disa paragrafeve në vende të ndryshme; • <i>Paraqitja dhe bashkimi</i> i ideve dhe koncepte janë relativisht të qartë dhe të kuptueshme, por mund të duan shtjellim të mëtejshëm; • <i>Metodologjia e përdorur</i> është e detajuar dhe mbështet rezultatet e paraqitura;

		• <i>Rezultatet</i> duan një farë ripunimi/plotësimi me shpjegime shitesë, ndërsa <i>interpretimi</i> i tyre edhe nëse ka bazë shkencore të dokumentuar, mund të dojë shtjellim të mëtejshëm; • <i>Përfundimet</i> e paraqitura mbështesin rezultatet, por mund të përmirësohen për tu dalluar më mirë kontributi shkencor i artikullit; • <i>Figurat</i> nuk kanë probleme madhore të konceptimit ose vizatimit në përgjithësi, por mund të duan njëfarë ripunimi, zëvendësimi i pamjeve të ndryshme, të cilat mund të jenë të paqarta, ose bashkimi i dy figurave; mund të kërkohet heqja ose shtimi i figurave në artikull. • <i>Tabelat</i> janë të qarta dhe me informacion të mjaftueshëm, por mund të kërkohet njëfarë rishikim i tyre. • Mund të duhet korrigjim të gjuhës dhe redaktim.
c.	Botim i pranuar pas ripunimit të thellë (Major Revision)	• <i>Artikulli ka potencial</i> për tu publikuar me korrigjimet përkatëse; • <i>Ai nuk plotëson</i> të gjitha kërkesat organizative të Buletinit dhe do ristrukturim rrënjësor; • <i>Ka probleme në konceptim</i>, në paraqitjen e ideve dhe të koncepteve dhe do rishikim të tyre; • <i>Rezultatet</i> nuk mbështeten plotësisht nga metodat e përdorura; • <i>Ka gabime në interpretim</i> të rezultateve dhe/ose interpretimi nuk është i mjaftueshëm dhe i mbështetur me referenca; • <i>Do informacion shitesë</i> për të mbështetur idetë e paraqitura; • <i>Përfundimet</i> e artikullit janë pjesërisht në kundërshtim me rezultatet e paraqitura dhe duan rishikuar; • <i>Do ripunim të figurave</i>, ndryshimi totalisht ose shtimi i informacionit brenda tyre; • <i>Tabelat janë të paqarta</i> ose nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur të dhënat; • <i>Gjuha shkencore</i> e përdorur duhet përmirësuar dhe artikulli do redaktim rrënjësor.
d.	I papërshtatshëm për botim (Rejected)	• <i>Tematika</i> e artikullit nuk përputhet me fushat që mbulon Buletini; • Artikulli është i dobët nga ana e konceptimit dhe metodologjisë së përdorur;

		• Ka mungesa madhore në të dhëna; • <i>Rezultatet</i> nuk janë të qarta dhe janë keqinterpretuar; • <i>Përfundimet</i> nuk mbështesin rezultatet e dhëna; • Gjuha shkencore e përdorur dhe terminologjia nuk është saktë; • Botimi është plagjiaturë.
--	--	---

Rezultat i ekspertizës është kategorizimi i artikujve në:

- a. **Botim i pranuar me pak korrigjime (Minor revision).**
- b. **Botim i pranuar me korrigjime mesatare (Intermediate revision).**
- c. **Botim i pranuar pas ripunimit të thellë (Major revision).**
- d. **I papërshtatshëm për botim (Rejected).**

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky dokument, i cili përmban “Statuti i Bordit Editorial” hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm.

Miratohet

Drejtor i Përgjithshëm

ADRIAN BYLYKU

Tiranë 08/10/2025



Shënim: Shtojcat bashkëngjitur këtij dokumentit janë: Shtojca 1 – Deklarata bashkëautorësie; Shtojca 2 – Deklarata antiplagjiaturë; Shtojca 3 – Formulari i ekspertizës së jashtme.